



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenit 30.1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2023, miratoi këtë;

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

Neni 1

1. Transferohen mjetet nga granti qeveritar - 10, nga Investimet Kapitale - 30, si vijon;

1.1. Nga programi 66030 - Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ, kodi funksional - 0620, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike/shpenzime - Investime kapitale, kodi - 30, transferohen në kategorinë e Mallra dhe Shërbime kodi-13, si në vijim:

- Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet nga rruga "Zahir Pajaziti" deri te rruga "Skënderbeu", kodi-52871, shuma.....60,000.00 €
 - Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shakovicë, kodi 43146, shuma.....1,303.32 €
 - Rregullimi i hapësirave publike përgjatë lumit Llap në qytet, kodi 51897, shuma.....50,000.00 €
- Totali.....111,303.32 €**

Transferohen në:

Programin e Arsimit – nënprogrami -93120 - Arsimi fillor, kodi funksional-0912

- Mallra dhe shërbime.....111,303.32 €
- Totali.....111,303.32 €**

1.2. Nga programi 18165 – Infrastrukturë Publike, kodi funksional - 0451, Fondi Burimor-10, kategoria ekonomike/shpenzime - Investime kapitale, kodi-30, transferohen në kategorinë e Mallra dhe Shërbime kodi-13, si në vijim:

- Ndërtimi i mureve mbrojtëse, kodi 51880, shuma.....3,246.21 €
 - Ndërtimi dhe rindërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferikë, kodi 53888, shuma.....40,000.00 €
 - Meremetimi i rrugëve me zhavorr, kodi 53890.....40,000.00 €
 - Ndriçimi publik në rrugën “ Hakif Zejnullahu”, kodi 52940.....25,571.24 €
- Totali.....108,817.45 €**

Transferohen në:

Programin e Arsimit- nënprogrami -93120 - Arsimi fillor, kodi funksional-0912

- Mallra dhe shërbime.....108,817.45 €
- Totali.....108,817.45 €**

1.3. Nga nën programi 85005 – Shërbime Kulturore, kodi funksional - 0820, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike/shpenzime - Investime kapitale - kodi-30, transferohen ne kategorinë e Mallra dhe Shërbime kodi-13, si në vijim:

- Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, kodi 53897, shuma.....15,500.00 €
- Totali.....15,500.00 €**

Transferohen në:

Programin e Arsimit- nënprogrami -93120 - Arsimi fillor, kodi funksional-0912

- Mallra dhe shërbime.....15,500.00 €
- Totali.....15,500.00 €**

Neni 2

Transferi i mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi nga kategoria e shpenzimeve Investime Kapitale, kodi-30, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve bëhet për arsye se në disa kode të projekteve ka tepriçë të mjeteve, ndërsa në kategorinë e mallrave në arsim kemi mungesë për lëndë djegëse, furnizim me ushqim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-422/01-0055055/23
Podujevë, datë; 31 korrik 2023

